



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR DETAJIMIN E FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025 NË VITIN
2026 PËR BASHKINË BERAT**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028”, konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 977/1 datë 29.12.2025,

Ju paraqesim propozimin për detajimin dhe alokimin e fondeve të papërdorura në vitin buxhetor 2025 të trashëguara në vitin 2026; shpërndarjen e tyre në shpenzime korrente dhe kapitale, në programe buxhetore dhe njësi shpenzuese.

Bashkia Berat trashëgon nga viti 2025 në vitin 2026 fonde të papërdorura në shumën 186,036,339.22 Lekë.

1. Situata e fondeve

- o Totali i fondeve të trashëguara nga viti 2024 dhe të ardhurat e vitit 2025 arrijnë në **1,649,730,883.94 lekë**, nga të cilat **1,463,694,544.72 lekë** janë përdorur gjatë vitit 2025.
- o Mbetja për vitin 2026 është **186,036,339.22 lekë**, duke reflektuar fondet e papërdorura dhe të planifikuara për përdorim në projekte dhe shërbime të ardhshme.

2. Fondet nga të ardhurat e veta

Nga totali i të ardhurave të veta prej **613,087,282.52 lekë**, një pjesë e konsiderueshme **134,207,016.87 lekë** rezulton e papërdorur dhe e trashëguar për vitin 2026.

Shuma e lartë e papërdorur lidhet kryesisht me arkëtimet e realizuara në muajin dhjetor të vitit 2025.

3. Transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale

- o Fondet nga transfertat e përgjithshme të pakushtëzuara **23,796,306.59 lekë** dhe sektorale **21,728,793.13 lekë** mbeten të papërdorura për projekte të nisura por të pa-realizuara në vitin 2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- o Këto fonde do të vazhdojnë të përdoren në vitin 2026 për realizimin e projekt-programeve të planifikuara.

4. Granti i bazuar në Performancë

Granti bazuar në performancë është fond i akorduar në fund të vitit 2025, i papërdorur, duke u mbartur për vitin 2026.

5. Sponsorizime

Sponsorizimet (të ardhura jashtë limitit kapitull 06) kanë një pjesë të papërdorur 818,553.42 lekë , të cilat gjithashtu do të kontribuojnë në financimin e aktiviteteve të planifikuara.

Sipas akt-trashëgimisë të mbajtur me degën e thesarit Berat shuma e të ardhurës që trashëgohet në vitin 2026 është **186,036,339.22** lekë, e cila rezulton si më poshtë :

në lekë

Kapitull	Emërtimi	Trashëguar nga viti 2024	Çelur në vitin 2025	Totali i të ardhurave 2024+2025	Përdorimi në vitin 2025	Mbetje trashëgimi për vitin 2026
01	Shuma kap. 1	86,101,886.79	944,928,547.21	1,031,030,434.00	982,808,705.07	48,221,728.93
01	Transferta e Përgjithshme e Pakushtëzuar	63,609,283.66	576,626,865.00	640,236,148.66	616,439,842.07	23,796,306.59
01	Transferta e Përgjithshme Sektoriale	22,492,603.13	365,605,053.00	388,097,656.13	366,368,863.00	21,728,793.13
01	Granti Bazuar ne Performance	-	2,696,629.21	2,696,629.21	-	2,696,629.21
02	Transferta nga grante te huaja	-	2,789,040.00	2,789,040.00	-	2,789,040.00
05	Të Ardhurat e Veta (pjesa e institucionit)	82,330,437.77	530,756,844.75	613,087,282.52	478,880,265.65	134,207,016.87
06	Sponsorizime	1,416,002.42	1,408,125.00	2,824,127.42	2,005,574.00	818,553.42
	Total	169,848,326.98	1,479,882,556.96	1,649,730,883.94	1,463,694,544.72	186,036,339.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Detajimi i fondeve të papërdorura të trashëguara nga viti 2025 në vitin 2026

Totali i fondit të trashëguar për vitin 2026 është 186,036,339.22 , nga të cilat sjellim detajimin për 183,339,710 Lek, duke përfshirë Grantin Bazuar Në Performancë.

Fondi i trashëguar në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë, në shumën 2,696,629.21 lekë, nuk është përfshirë në këtë material për qëllim destinimi, pasi alokimi i tij do të trajtohet me vendim të veçantë, në përputhje me kriteret dhe kushtet specifike që rregullojnë përdorimin e këtij granti. Ky fond do të planifikohet në përputhje me prioritetet e përcaktuara dhe me udhëzimet përkatëse ligjore, duke garantuar transparencë dhe respektim të plotë të kuadrit rregullator.

- ✓ Fondet e trashëguara përdoren kryesisht për investime kapitale dhe projekte strategjike.
- ✓ Një pjesë e vogël shkon për shpenzime operative dhe mbështetje sociale.
- ✓ Kjo shpërndarje garanton vijimësinë e projekteve dhe shërbimeve publike, duke respektuar klasifikimin ekonomik dhe ligjor të shpenzimeve.

1. Shpenzime Kapitale (artikujt 230, 231) - 130,083,740 Lekë (71%)

Pjesa dominuese e fondit është e orientuar drejt investimeve kapitale.

Kjo tregon orientimin e strategjisë së Bashkisë drejt zhvillimit të qëndrueshëm urban, përmirësimit të infrastrukturës dhe projekteve me ndikim afatgjatë.

Në shpenzimet kapitale të financuara nga transfertat dhe të ardhurat e veta kemi:

kod prog.	Pershkrimi	vlera Lek
	Total shpenzime kapitale (kapitull 01+05)	129,183,871
AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile	53,121,068
231	Nderhyrje ne infrastrukturen e Tregut Industrial Berat	17,840,309
231	Rikonstrukcion i rruges " Gaqi Gjika"	9,796,000
231	Rehabilitim i Varrezave te Deshmoreve	3,700,000
231	Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra e të pafavorizuara, bashkëfinancim me MSH kontrata 2025-2026	9,519,564
231	Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime, kolaudime, shpronësime	4,465,195
230	Detyre projektimi per ndertimin e qendres multifunksionale dhe parkim nentokesor Bashkia Berat	4,800,000
230	Hartim projekte	3,000,000
AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social	56,885,719



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor, bashkëfinancim me MAS	26,191,601
231	Mbikqyrje punimesh për objektin "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor"	1,184,565
231	Rikonstruktion total i Shkolles se Mesme te Bashkuar "Koço Brisku" Lapardha	15,958,757
231	Fond për projekte dhe bashkefinancime në fushën e arsimit	5,000,000
231	Ndërtim i sportit Shkolla Lapardha	3,020,120
231	Punime ndërtimi në godinat arsimore	3,469,823
231	Rehabilitim i njëjtit sanitare në kopshte	560,853
231	Blerje elektroshtepiake dhe pajisje për ngrohje	1,200,000
231	Blerje pajisje zyre	300,000
AD102	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	5,141,466
231	Veshje me beton kanal ujë në Lapardha dhe Starove	4,300,000
231	Pyllezim në malin Partizan	638,256
231	Orendi zyre	83,210
231	Blerje printer	120,000
AE102	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	3,968,107
231	Shpenzime kapitale për mbrojtjen civile	3,968,107
AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet	10,067,511
231	Rikonstruktion Qendra Rinore Lapardha	9,567,511
231	Blerje pajisje dhe materiale logjistike	500,000

2. Shpenzime Korente (artikujt 602, 604, 606) – 53,180,970 Lekë (29%)

- o Përfshin shpenzime për mallra dhe shërbime, transfera të brendshme dhe për buxhete familjare/individë.
- o Këto shpenzime mbulojnë funksionimin e përditshëm të institucioneve, mbështetjen e shërbimeve sociale dhe të rasteve të emergjencave, duke garantuar që shërbimet publike të mos ndërpriten.

3. Paga dhe Sigurime (artikujt 600-601) – 75,000 Lekë (<1%)

Pesha minimale e kësaj kategorie tregon se fondi i trashëguar nuk është orientuar drejt rritjes së kostos administrative, por kryesisht drejt funksionimit dhe investimeve.

- o Përfshin vetëm shpenzime për paga, (dalje në pension 1 rast tek Qendra "Lira")
- o Pesha minimale e kësaj kategorie krahasuar me totalin, tregon se fondet e trashëguara përdoren kryesisht për projekte dhe investime, jo për shpenzime operative rutinore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Tabela e Detajimit të të Ardhurave të Trashëguara nga viti 2025 në vitin 2026

Emërtimi i Artikullit	Kodi i Artikullit	2026	01	01.1	05	06	02
		Total Shtesa e buxhetit	Transferta e Përgjithshme e Pakushtëzuar	Transferta e Përgjithshme Sektoriale	Të Ardhurat e Veta	Sponsorizime	Transferta nga grante te huaja
Paga dhe Sigurime		75,000	0	75,000	0	0	0
Paga, Shpërblime & Tjera Personeli	600	75,000	0	75,000	0	0	
Sigurimet Shoq. & Shëndetësore	601	0	0	0	0	0	
Korente te Tjera		53,180,970	3,138,258	3,993,424	43,241,564	18,683	2,789,040
Mallra dhe Shërbime	602	48,738,651	3,138,258	1,851,105	40,941,564	18,683	2,789,040
Subvencion	603	0	0	0	0	0	
Transferta të Brendshme	604	2,000,000	0	0	2,000,000	0	
Transferta për Buxh. Famil. & Indiv.	606	2,442,319	0	2,142,319	300,000	0	
Rezervat	609	0	0	0	0	0	
Shpenzime Kapitale		130,083,740	20,658,049	17,660,369	90,965,453	799,870	0
Shpenzime Kapitale te Patrupezuara	230	7,800,000	4,800,000	0	3,000,000	0	
Shpenzime Kapitale te Trupezuara	231	122,283,740	15,858,049	17,660,369	87,965,453	799,870	
Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	255	0	0	0	0	0	
TOTALI		183,339,710	23,796,307	21,728,793	134,207,017	818,553	2,789,040

1. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e trashëguar nga viti 2025 është në shumën 21,728,793.13 lekë

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 28, pika 5, fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar sektoriale në fund të vitit buxhetor trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren në të njëjtin funksion për të cilin janë akorduar.

Alokimi i propozuar për vitin 2026 është në përputhje të plotë me destinacionin funksional të përcaktuar në aktet e buxhetit të vitit 2025 dhe nuk ndryshon natyrën apo qëllimin e transfertës, por siguron vijimësinë e projekteve, përmbushjen e detyrimeve të krijuara dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Alokimi i propozuar siguron:

- Reagim ndaj emergjencave dhe fatkeqësive natyrore;
- Përmirësim të infrastrukturës arsimore;
- Forcim të mbrojtjes civile;
- Mbështetje të sektorit bujqësor dhe menaxhimit të burimeve natyrore;
- Vijimësi të shërbimeve sociale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

1.1. Bashkia Berat (Aparati) – 6,294,997 lekë

✚ Programi AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile
2,142,319 lekë

Fondi parashikohet për transferta për familje dhe individë të dëmshpërblyer për dëme të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, duke garantuar mbështetje financiare dhe reagim institucional ndaj situatave emergjente.

✚ Programi AE102 – Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile
4,152,678.00 lekë

Fondi përdoret për:

- Shpenzime operative për raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit;
- Shpenzime kapitale për forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes civile.

Kjo shpërndarje garanton rritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e infrastrukturës së reagimit emergjent, si edhe mbrojtjen e popullatës.

1.2. Drejtoria e Arsimit – 8,250,796 lekë

✚ Programi AC102 – Arsimi & Kujdesi Social

Fondet do të përdoren për:

- Ndërtimin e këndit sportiv në Shkollën Lapardha;
- Punime ndërtimi në godina arsimore;
- Rehabilitim të nyjeve sanitare në kopshte;
- Blerje pajisjesh elektro-shtëpiake dhe pajisje për ngrohje.

Këto investime synojnë përmirësimin e kushteve fizike në institucionet arsimore dhe rritjen e standardeve të sigurisë dhe komoditetit për nxënësit.

1.3. Qendra “Lira” – 1,041,534.13 lekë

✚ Programi AC102 – Arsimi & Kujdesi Social

Fondet parashikohen për:

- Pagesa pagash (shpërblim për dalje në pension);
- Shpenzime operative;
- Blerje pajisjesh zyre.

Kjo shpërndarje siguron vijimësinë e funksionimit të qendrës dhe ofrimin e shërbimeve sociale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

1.4. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar – 6,141,466 lekë

🚧 Programi AD102 – Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve

Fondet do të përdoren për:

- Veshje me beton të kanaleve ujitëse në Lapardha dhe Starovë;
- Riparim të pritave malore;
- Pyllezim në malin Partizan;
- Blerje orendish dhe pajisjesh zyre.

Këto ndërhyrje kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës ujitëse, mbrojtjen e tokave bujqësore, menaxhimin e burimeve natyrore dhe forcimin e kapaciteteve administrative të drejtorisë.

Detajimi i transfertës sektoriale të trashëguar 21,728,793.13 lekë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Prog.	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001			Bashkia Berat (Aparati)			6,294,997.00
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			2,142,319.00
2102001	01.1	AB102	V091AAC	606	Transferta për Buxh. Familje& Individë Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore	2,142,319.00
2102001		AE102	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			4,152,678.00
2102001	01.1	AE102	V328AAC	602	Shpenzime operative per Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit	184,571.00
2102001	01.1	AE102		231	Shpenzime kapitale per mbrojtjen civile	3,968,107.00
2102005			Drejtoria Arsimore Bashkia Berat			8,250,796.00
2102005		AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social			8,250,796.00
2102005	01.1	AC102	V923AAB	231	Ndertim kendi sportiv Shkolla Lapardha	3,020,120.00
2102005	01.1	AC102	V923AAB	231	Punime ndertimi ne godinat arsimore	3,469,823.00
2102005	01.1	AC102	V912AAB	231	Rehabilitim nyje sanitare ne kopshte	560,853.00
2102005	01.1	AC102	V912AAB	231	Blerje elektroshtepiake dhe paisje per ngrohje	1,200,000.00
2102020			Qendra "Lira"			1,041,534.13
		AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social			1,041,534.13
2102020	01.1	AC102	V043AAB	600	Paga	75,000.00
2102020	01.1	AC102	V043AAB	602	Shpenzime operative	666,534.13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2102020	01.1	AC102	V043AAB	231	Blerje pajisje zyre	300,000.00
2102022	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar					6,141,466.00
		AD102	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve			6,141,466.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	231	Veshje me beton kanal ujites ne Lapardha dhe Starove	4,300,000.00
2102022	01.1	AD102	V424AAB	231	Orendi zyre	83,210.00
2102022	01.1	AD102	V426AAE	231	Pyllezim ne malin Partizan	638,256.00
2102022	01.1	AD102	V426AAB	231	Blerje printer	120,000.00
2102022	01.1	AD102	V426AAD	602	Riparim prita malore	1,000,000.00
total						21,728,793.13

2. Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme e trashëguar nga viti 2025 në shumën 23,796,306.59 lekë

Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për financat e vetëqeverisjes vendore, përbën burim financiar që i jep njësisë së vetëqeverisjes vendore fleksibilitet në përdorim, në funksion të prioriteteve të zhvillimit vendor dhe garantimit të shërbimeve publike.

Fondet e papërdorura të trashëguara nga viti buxhetor 2025, në shumën 21,658,048.59 lekë, propozohet të alokohen në përputhje me nevojat prioritare të vitit 2026, si më poshtë:

2.1. Bashkia Berat (Aparati) – 23,796,306.59 lekë

Programi AA102 – Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse 1,000,000 lekë

Fondi parashikohet për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt administrativ dhe mbështetjen e strukturave të institucionit.

Programi AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile 20,658,048.59 lekë

Fondet do të përdoren për:

- Detyrë projektimi për ndërtimin e Qendrës Multifunkionale dhe parkimit nëntokësor pranë Bashkisë Berat;
- Investime të reja në infrastrukturën rrugore, përfshirë shpenzime për supervizime, kolaudime dhe shpronësime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Kjo shpërndarje synon të përshpejtojë realizimin e projekteve strategjike infrastrukturore dhe të forcojë kapacitetet urbane të qytetit, duke krijuar kushte më të mira për zhvillim dhe shërbime ndaj qytetarëve.

Shpërndarja e fondeve të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				23,796,306.59
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			1,000,000.00
2102001	01	AA102	V111AAD	602	Shpenzime operative dhe mirembajtje	1,000,000.00
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			20,658,048.59
2102001	01	AB102	P452AAU	230	Detyre projektimi për ndertimin e qendres multifunkionale dhe parkim nentokesor Bashkia Berat	4,800,000.00
2102001	01	AB102		231	Nderhyrje në infrastrukturën e Tregut Industrial Berat	15,858,048.59
		AD102	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve			2,138,258.00
2102001	01	AD102	P422AAF	602	Shpenzime për menaxhimin e projektit HEVON (Fond MFE për parafinancim)	2,138,258.00
Total						23,796,306.59

3. Të Ardhurat e Veta/Lokale të trashëguara nga viti 2025 në shumën 134,207,016.87 lekë

Fondet e trashëguara me burim financimi nga të ardhurat vendore, në shumën totale 134,207,016.87 lekë, propozohet të shpërndahen sipas njësive shpenzuese, programeve buxhetore dhe natyrës së shpenzimeve, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të prapambetura, vijimin e projekteve investuese dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike.

3.1. Bashkia Berat (Aparati) – 126,295,916.87 lekë

 **Programi AA102 – Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse**
Totali: 29,828,344 lekë

Këto fonde parashikohen për:

- Likuidimin e faturave operative të muajit dhjetor 2025;
- Shpenzime për pritje dhe përcjellje në funksion të përfaqësimit institucional;
- Shpërblimin e këshilltarëve dhe kryeqendrës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

- Transferime ndaj Këshillit të Qarkut dhe agjentëve të taksave;
- Përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga vendime gjyqësore.

Kjo shpërndarje synon garantimin e funksionimit normal administrativ dhe përbushjen e detyrimeve ligjore të institucionit.

Programi AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile **Totali: 37,463,018.87 lekë**

Fondet në këtë program adresojnë:

- Ndërhyrje në infrastrukturën e Tregut Industrial Berat
- Rikonstruktionin e rrugës “Gaqi Gjika”;
- Rehabilitimin e Varrezave të Dëshmorëve;
- Bashkëfinancimin për përmirësimin e banesave për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara;
- Hartimin e projekteve teknike;
- Investime të reja në infrastrukturën rrugore, përfshirë supervizime, kolaudime dhe shpronësime;
- Fond rezervë për emergjencat civile.

Kjo shpërndarje siguron vijimësinë e projekteve infrastrukturore dhe rrit kapacitetin e reagimit në raste emergjente.

Programi AC102 – Arsimi & Kujdesi Social **Totali: 48,934,923.00 lekë**

Fondet parashikohen për:

- Bashkëfinancimin dhe vijimin e ndërtimit të shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” dhe parkimit nëntokësor;
- Mbikëqyrjen e punimeve për këtë objekt;
- Rikonstruktionin total të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Koço Brisku”, Lapardha;
- Fond për projekte dhe bashkëfinancime në fushën e arsimit;
- Shpenzime operative dhe transfera për familje dhe individë në kushte të vështira social-ekonomike.

Këto fonde garantojnë vijimin e investimeve në infrastrukturën arsimore dhe mbështetjen e shtresave në nevojë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

🚧 Programi AE102 – Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile
Totali: 402,120 lekë

Fondi përdoret për shpenzime operative në funksion të menaxhimit të rasteve të zjarrit dhe operacioneve të shpëtimit, duke garantuar gatishmëri operacionale.

🚧 Programi AF102 – Turizmi, Kultura dhe Sportet
Totali: 9,567,511 lekë

Fondi është planifikuar për rikonstruksionin e Qendrës Rinore Lapardha, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës sociale dhe kulturore për të rinjtë.

3.2. Agjencia e Shërbimeve Publike – 3,613,800 lekë

🚧 Programi AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile

Fondi parashikohet për punime sinjalistike rrugore, me synim rritjen e sigurisë rrugore dhe përmirësimin e standardeve të qarkullimit. (Kontrata është lidhur në muajin 12/25)

3.3. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” – 4,297,300 lekë

🚧 Programi AF102 – Turizmi, Kultura dhe Sportet

Fondet do të përdoren për:

- Organizimin e aktiviteteve kulturore, konkretisht për aktivitetin “Green Marathon”;
- Blerje pajisjesh dhe materiale logjistike.

Kjo shpërndarje synon gjallërimin e jetës kulturore dhe promovimin e qytetit përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore.

Shpërndarja e fondeve të trashëguara me burim financimi të ardhurat vendore , shuma 134,207,016.87 lekë, si më poshtë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				126,295,916.87
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			29,928,344.00
2102001	05	AA102	V111AAD	602	Shpenzime operative (fatura te 12/2025)	749,344.00
2102001	05	AA102	V360AAA	602	Shpenzime operative (fatura te 12/2025)	216,000.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2102001	05	AA102	V360AAA	602	Shpenzime per pritje percjellje	1,100,000.00
2102001	05	AA102	V111AAB	602	Shperblimi per keshilltaret dhe kryepleqte	863,000.00
2102001	05	AA102	V112AAB	604	Transferime tek keshilli i qarkut, agjentet e taksave	2,000,000.00
2102001	05	AA102	V111AAG	602	Shpenzime per detyrimet nga vendimet gjyqesore	25,000,000.00
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			37,463,018.87
2102001	05	AB102	P066AAB	231	Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra e të pafavorizuara, bashkëfinancim me MSH (22,212,316+9,519,564)	9,519,564.00
2102001	05	AB102		231	Rikonstruksion i rruges " Gaqi Gjika"	9,796,000.00
2102001	05	AB102		231	Rehabilitim i Varrezave te Deshmoreve	3,700,000.00
2102001	05	AB102		231	Nderhyrje ne infrastrukturen e Tregut Industrial Berat	1,982,260.00
2102001	05	AB102	P452AAV	231	Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime, kolaudime, shpronësime	4,465,194.87
2102001	05	AB102	P452AAU	230	Hartim projekte	3,000,000.00
2102001	05	AB102		602	Shpenzime per emergjencat civile	5,000,000.00
2102001		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			48,934,923.00
2102001	05	AC102	P912AAR	231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor, bashkëfinancim me MAS (250,897,872+170,106,558)	26,191,601.00
2102001	05	AC102	P912AAR	231	Mbikqyrje punimesh per objektin "Ndertim i shkolles 9-vjecare "22 Tetori" parkim nentokesor"	1,184,565.00
2102001	05	AC102	P912ACB	231	Rikonstruksion total i Shkolles se Mesme te Bashkuar "Koco Brisku" Lapardha	15,958,757.00
2102001	05	AC102	V912AAD	231	Fond per projekte dhe bashkefinancime ne fushen e arsimit	5,000,000.00
2102001	05	AC102	V014AAB	602	Shpenzime operative	300,000.00
2102001	05	AC102	V014AAB	606	Transferta për Buxh. Familje& Individë në kushte të vështira social-ekonomike	300,000.00
2E+06		AE102	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			402,120
2102001	05	AE102	V328AAC	602	Shpenzime operative per Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit	402,120
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			9,567,511.00
2102001	05	AF102	P822AAZ	231	Rikonstruksion Qendra Rinore Lapardha	9,567,511.00
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike					3,613,800.00
		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			3,613,800.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2102004	05	AB102	V626AAC	602	Punime sinjalistike rrugore	3,613,800.00
2102006	Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"					4,297,300.00
		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			4,297,300.00
2102006	05	AF102	V823AAA	602	Shpenzime per aktivitete kulturore, Aktiviteti "Green Marathon"	3,797,300.00
2102006	05	AF102		231	Blerje pajisje dhe materiale logjistike	500,000.00
Total						134,207,016.87

4. Transferta nga grante të huaja - 2,789,040 Lekë

Shuma totale prej **2,789,040 Lekë** paraqet mbartet nga viti 2025 dhe lidhet me projekte specifike të financuara nga donatorë ndërkombëtarë.

Kod Instituti	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001	Bashkia Berat (Aparati)					2,789,040.00
2102001		AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërrave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore			2,138,259
2102001	02	AD102	P422AAF	602	Shpenzime per menaxhimin e projektit "HEVON"	2,138,259
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			650,781
2102001	02	AF102	P823AAD	602	Shpenzime operative per projekin "RiseUp EB"	650,781
					Total	2,789,040.00

5. Sponsorizimet 818,553.42 lekë

Fondet me burim financimi Sponsorizime (kap. 06) janë me destinacion për financimin e shpenzimeve të përcaktuara në kontratën e sponsorizimit. Këto fonde detajohen dhe përdoren vetëm në destinacionin përkatës

Shpërndarja e fondeve të trashëguara me burim financimi Sponsorizimet, shuma 818,553.42 lekë :

Kod Instituti	Kap. Fin.	Programi	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001	06	AA102	602	Erasmus +	503.42
2102001	06	AB102	231	Alpha Bank, sponsorizim per rikonstruksionin e Shatervanit	205,000.00
2102001	06	AB102	231	Sponsorizim FLAG Projekti "Siguria publike ne nivel vendor"	562,000.00
2102001	06	AC102	602	Te ndryshem por te barabarte & Askush te mos mbetet si ju	407.00
2102001	06	AC102	231	Save the Children, "Kend sportiv dhe rekreativ ne shkollen Velabisht, Berat"	32,870.00
2102001	06	AD102	602	"Trans Adriatik Pipeline"	17,773.00
				Total	818,553.42



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Për sa më sipër, ftojmë anëtarët e Këshillit Bashkiak të votojnë pro këtij propozimi, me qëllim vijimësinë dhe përfundimin me sukses të projekteve të financuara.

Ju faleminderit ,

GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK

Ervin CECA
Kryetar i Bashkisë (NA)

Arisa TOSKA
Sekretar i Përgjithshëm (Koordinator)

Bledar ÇILI
N/Kryetar i Bashkisë
Drejtore i NJ.SH. Drejtoria e Bujqësisë

Etleva DHIMA
N/Kryetar i Bashkisë

Rovena SHEHU Drejtore i Financës dhe Buxhetit (Sekretar i GMS)

Marius QYTYKU Drejtore i Integritetit Europian dhe Planifikimit Strategjik

Erida NASUFI Drejtore i Komanduar

Daniel BENISHTA Drejtore i Komanduar i Taksave Lokale

Petro SINJARI Drejtore i Drejtorisë Juridike

Sokol TOSKA Drejtore i Mbrojtjes Civile, Pronave Transportit dhe, Shërbimeve

Marjush ÇEPELE Drejtore i Komanduar i Turizmit dhe Aktiviteteve

Gentian DASHI Drejtore i Burimeve Njerëzore

Piro XHEBLATI Drejtore i Shërbimit Social

Majlinda MAHMUTAJ Drejtore i Arsimit, Kulturës dhe Rinisë

Kreshnik ZAIMI Drejtore i Policisë Bashkiake

Artan MERKO Drejtore i MZSH

Klodiana HOXHA Drejtore i NJ.SH. Drejtoria Arsimore

Joana MELËNGU Drejtore i NJ.SH. Agjencia e Shërbimeve Publike

Arben QAFA Drejtore i NJ.SH. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”

Alma KULE Drejtore i NJ.SH. Qendra “LIRA”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR

MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT
DHE TË NJËSIVE SHPENZUESE NË VARËSI TË SAJ PËR VITIN 2026

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 103 datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar , Vendimin nr. 87, datë 06.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar , ka miratuar ndryshimin e nivelit të pagave të punonjësve në institucionet e vetëqeverisjes vendore, duke caktuar kufijtë e pagave mujore të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë në këto institucione. Këto ndryshime janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave.

Në Vendimin nr. 103 datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, janë ndryshuar kufijtë minimalë dhe maksimalë të pagës për pozicion **si rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave.**

Bashkia Berat për efekt page grupohet tek kategoria e bashkive me 50,001 – 100,000 banorë. Numri i përgjithshëm i punonjësve në strukturën organike të vitit 2026 është 816.

- ✓ **Për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar**, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr. 328 datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM nr. 103 datë 11.02.2026, janë bërë ndryshimet e pagës si më poshtë :
- Kufijtë e pagave mujore, për funksionarët e zgjedhur të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore sipas Lidhjes nr. 1 pika c , të VKM-së .
- Paga për administratorët e njësive administrative, në kufijtë minimalë dhe maksimalë sipas Lidhjes nr. 8 të VKM-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Bashkia Berat për katëgoritë Kryetar, Nënkyetar , Administrator i Njesisë Administrative propozon pagën maksimale, në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur këtij relacioni.

- ✓ **Për nëpunësit civilë të bashkisë si edhe punonjësit me pagë grupi në njësitë në varësi,** të cilët përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr. 328 datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM nr. 103 datë 11.02.2026, ndryshimet e pagës janë bërë në komponentët e saj, si më poshtë :
- + Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, ka ndryshuar në kufijtë minimalë dhe maksimalë në lidhjen nr. 5 të VKM-së.
- + Shtesa e nivelit të kualifikimit (paga e grupit) ka mbetur e pandryshuar për të 3 grupet e diplomës së arsimit të lartë
- + Shtesa për vjetërsi mbetet e pandryshuar. Ajo llogaritet mbi pagën e pozicionit në masën 0.6 % pas cdo viti për 10 vitet e para (1-10 vite), 0.8 % pas cdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite), dhe 1% pas cdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite).

Bashkia Berat, propozon nivelin e pagave si në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 bashkëngjitur këtij relacioni. Për të gjithë nëpunësit civilë është parashikuar paga për pozicion në nivelin maksimal.

- ✓ **Për punonjësit “Polic Bashkiak”** niveli i pagës bazë mujore të jetë 65,000 lekë në muaj. Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.
- ✓ **Për punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme,** në bashki dhe në njësitë në varësi të saj, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të VKM-së nr. 326 datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026, kemi:
 - + Paga bazë ka ndryshuar. Për secilën klasë është rritur me 10,000 lekë. Kufijtë e pagave bazë të punonjësve administrativë janë nga 50,000 – 57,000 lekë në muaj
 - + Për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse në masën 4,000 lekë në muaj.
 - + Shtesa për vjetërsi në punë ka mbetur e pandryshuar; llogaritet në masën 1% të pagës bazë, pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

Shënojmë se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij projekt vendimi për vitin 2026, përballohen nga plani i shpenzimeve të personelit të miratuar në buxhetin e bashkisë Berat për vitin 2026, miratuar nga këshilli bashkiak në muajin dhjetor 2025.

Kujtojmë që bashkisë i është akorduar transfertë për rritjen e pagave në shumën 90,994,728 lekë, miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ç”, neni 55, pika 2; në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

vetëqeverisjes vendore”, nenit 2, shkronja “c” dhe neni 5, në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike” i ndryshuar, ligjin 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, neni 6 shkronja “c”, neni 9, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 103 datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 06.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, si edhe në strukturën organizative të Bashkisë Berat të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 832 datë 05.12.2025 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në Varësi të Bashkisë Berat për Vitin 2026”,

Ju kërkohet të miratoni propozimin për nivelin e pagave sipas Lidhjeve Nr. 1, 2, që i bashkëlidhen këtij relacioni

Faleminderit!

KRYETAR
Ervin CECA

Sekretar i Përgjithshëm
Arisa TOSKA

Drejtor i Burimeve Njerëzore
Gentian DASHI

Drejtor i Financës dhe Buxhetit
Rovena SHEHU

Drejtor Juridik
Petro SINJARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për funksionarët, nëpunësit civilë dhe punonjësit në Bashkinë e Beratit

Në zbatim të VKM nr. 103 datë 11.02.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar

Emërtimi	Kategoria/ Klasa	Paga për Pozicion
Kryetar i Bashkisë	Lidhja 1, pika c	266,500
Nënkryetar i Bashkisë	Lidhja 1, pika c	210,125
Administrator në Njësitë Administrative me 20,001-50,000 banorë (lagjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 te qytetit)	Lidhja 8, pika 2	158,875
Administrator në Njësitë Administrative me 5,001-20,000 banorë (Otlak, Velabisht, Sinje)	Lidhja 8, pika 3	148,625
Administrator në Njësitë Administrative me më pak se 5,000 banorë (Roshnik)	Lidhja 8, pika 4	143,500
Sekretar i Përgjithshëm	I-4	184,500
Sekretar i Këshillit Bashkiak	II-2	144,525
Drejtori i Kabinetit të Kryetarit	II-2	144,525
Drejtor Drejtorie	II-2	144,525
Këshilltar në Kabinet	III-2	109,000
Përgjegjës sektori	III-2	109,000
Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit	III-2	109,000
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	IV-2	85,000
Specialist, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-2	85,000
Specialist, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-3	75,000
Specialist, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-4	65,000
Ndihmës Sekretar i Këshillit Bashkiak	IV-4	65,000
Ekonomist në repartin e MZSH-së	IV-2	85,000
Punonjës Protokoll-Arkivi e magazinë në repartin e MZSH-së	IV-2	85,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit në institucionet në varësi të Bashkisë së Beratit

Në zbatim të VKM nr. 87 datë 06.02.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar (pika 10)

E M Ë R T I M I	Kategoria/ Klasa	Paga për Pozicion
Drejtor në Njësiti Vartëse të Bashkisë	II-2	144,525
Përgjegjës Sektori në Njësiti Vartëse të Bashkisë	III-2	95,000
Përgjegjës Sektori në Njësiti Vartëse të Bashkisë	III-3	90,000
Shef Finance në Njësiti Vartëse (Qendra Kulturore "M. Tutulani", Drejtoria e Bujqësisë)	III-3	90,000
Përgjegjës në Njësiti Vartëse të Bashkisë	III-3	80,000
Përgjegjës në Njësiti Vartëse të Bashkisë	IV-2	80,000
Specialist, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-2	77,000
Specialist, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-3	75,000
Specialist, si edhe të gjitha pozicionet e punës të barasvlefshme me këtë kategori sipas emërtimeve përkatëse	IV-4	65,000
Bibliotekare	IV-3	75,000
Koreograf	IV-3	75,000
Përgjegjëse çerdheje	IV-2	80,000
Edukatore në çerdhe me diplomë arsimit të lartë	IV-4	65,000

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për grupet e diplomave të arsimit të lartë

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së Master i Shkencave, Master i Arteve "Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike." Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14,000
2	Niveli 7 i KSHK-së	12,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	
3	Niveli 6 i KSHK-së Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10,000

1. Shtesa për vjetërsi për punonjësit e lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 të jepet në masën 0.6 % pas çdo viti për 10 vitet e para (1-10 vite), 0.8 % pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite), dhe 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe të llogaritet mbi pagën e pozicionit.
2. Specialistët e IT me diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave”/“Master profesional”/“Bachelor” apo të barasvlefshme me ta, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “ Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Shkenca kompjuterike”, “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike”, “Informatikë biznesi”, “Inxhinieri matematike- informatike” dhe “Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)”, përfitojnë shtesë për kushte pune (natyrë të veçantë pune) në masën 5,000 (pesë mijë) lekë në muaj.
3. Për punonjësit administrativë në të gjitha njësitë shpenzuese të Bashkisë Berat , niveli i pagës të jetë sipas Vendimit nr. 87, datë 06.02.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

Për punonjësit administrativë, për natyrë të veçantë pune jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse në masën 4,000 lekë në muaj.

4. Për punonjësit “Polic Bashkiak” niveli i pagës bazë mujore të jetë 65,000 lekë në muaj.
Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet.

KRYETAR
Ervin CECA

Sekretar i Përgjithshëm	Arisa TOSKA
Drejtor i Burimeve Njerëzore	Gentian DASHI
Drejtor i Financës dhe Buxhetit	Rovena SHEHU
Drejtor Juridik	Petro SINJARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

RELACION
MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E Z.EDMOND MITA

Të nderuar Këshilltarë,

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Berat ofron për familjet e pastreha, si dhe për familjet në kushte të vështira sociale dhe ekonomike, bazuar në pikën 34 dhe 45 të nenit 2, si dhe nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 459, datë 03.07.2019 “Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, paraqesim për miratim bonusin e qirasë për familjen e z. Edmond Mita.

Bazuar në germën “c” “Kushtet sociale të familjes” të nenit 16 “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve” të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, familja e Edmond Mitës përbëhet nga tre persona dhe plotëson tre kushtet si më poshtë:

1. **Kushtin e strehimit**, pasi familja është kthyer nga emigrimi dhe ka jetuar për një periudhë me qira, por për shkak të pamundësisë financiare për të paguar qiranë mujore është nxjerrë nga banesa. Më pas, për një periudhë kohe, ka jetuar në kushte të papërshtatshme, përfshirë trotualet e rrugës së Kalasë, dhe më vonë është strehuar në ambientet e një kulti fetar.
2. **Kushtin social**, si familje “emigrantë të rikthyer”.
3. **Kushtin ekonomik**, duke qenë aktualisht familje pa të ardhura.

Familjet që plotësojnë të tre këto kushte, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, kanë përparësi në trajtimin e kërkesës për strehim. Duke qenë se kjo familje e kishte të pamundur të siguronte në tregun e lirë një banesë me kontratë qiraje për shkak të mosbesimit të pronarëve lidhur me pagesën e rregullt të qirasë mujore, Bashkia u detyrua të marrë me qira një banesë në tregun e lirë, duke lidhur kontratë qiraje para noterit me nr. 558 repertori, nr. koleksioni 338, datë 11.02.2026. Banesa është e mobiluar, ndodhet në lagjen “30 Vjetori”, me nr. pasurie 15/241+1-15, me sipërfaqe 74 m², për ta dhënë me kontratë nënqiraje familjes së z. Edmond Mita. Sa më sipër, kërkojmë miratimin e bonusit të qirasë për familjen e z. Edmond Mita për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 11.02.2026 deri më 11.02.2027, në vlerën 233,933 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë.

Bashkëlidhur: Kontrata nr. 558 repertori, nr. koleksioni 338, datë 11.02.2026, e lidhur para noterit.

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

R E L A C I O N

“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z. ALFRED GJOZI, BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISË DHE BUXHETI I VITIT 2026 NË MINISTRINË E MBROJTJES, PROGRAMI “EMERGJENCAT CIVILE”

Të nderuar këshilltarë,

Në datën 02.12.2025, si pasojë e një zjarri të rënë, është dëmtuar banesa me pronar z. Alfred Gjozi, e ndodhur në Lagjen “Kushtrim”, Lagjja nr. 3, Bashkia Berat.

Pas arkivimit të kërkesës së z. Alfred Gjozi me nr. 1759 prot., datë 03.12.2025, komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 827, datë 03.12.2025, të Kryetarit të Bashkisë, “Për ngritjen e komisionit për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në datën 02.12.2025 në banesën me pronar z. Alfred Gjozi”, Lagjja nr.3, u paraqit në vendngjarje dhe në bazë të konstatimit fizik, hartoi procesverbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM nr.329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Procesverbali i konstatimit u përcoll në Këshillin e Qarkut me shkresën nr.7297 prot. datë 24.12.2025, për vlerësimin e dëmeve sipas legjislacionit në fuqi.

Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e z. Alfred Gjozi dhe e ka përcjellë atë në Bashkinë Berat me shkresën nr. 1173/1 prot., datë 30.01.2026.

Në mbështetje të preventivit të hartuar nga grupi i ekspertëve, rezultojnë këto dëme:

1.Në banesën e z. Alfred Gjozi, në vlerën totale 582,049 (pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyzet e nëntë) lekë, nga të cilat:

-Punime ndërtimore: 184,549 lekë

-Orendi dhe pajisje: 397,500 lekë

Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe në VKM nr. 329, datë 16.05.2012, Kreu III, pika 1, 3, shkronja “ç”, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e 50 % të vlerës së llogaritur si ndihmë e menjëhershme financiare për:

Familjen e z. Alfred Gjozi, në vlerën 291,024 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëzet e katër) lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile, për sigurimin e jetesës dhe kushteve të përkohshme të jetesës, si dhe për shpenzime të tjera të domosdoshme për përballimin e situatës emergjente.

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT**

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VKB NR.104, DATË 22.12.2025, “MBI MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARA UNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”

Të nderuar zotërinj këshilltarë!

Këshilli Bashkiak me vendim nr.104 date 22.12.2025 “Mbi miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin arsimor 2025-2026”, ka miratuar listën e nxënësve të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe janë përfitues të bursës si dhe përfitimeve të tjera, të parashikuara në:

- **VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të ndryshuar VKM Nr.511, datë 27.7.2022** “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”.

-Bazuar në nenin 33 të **VKM Nr.666, datë 10.10.2019 të ndryshuar VKM Nr.511, datë 27.7.2022** sipas të cilit “Vendimet e këshillave të NJVV, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afati vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse”

Në Drejtorinë Arsimore, Bashkia Berat është paraqitur kërkesa me nr.40/1 prot datë 29.01.2026 të shkollës së mesme profesionale “Stiljano Bandilli” “Kërkesë për bursë për disa nxënës në arsimin e mesëm profesional të cilët në fazën e parë të aplikimit kanë pasur mungesë dokumentacioni” .

Gjithashtu duke u mbështetur në:

➤ Në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë Kultures Dhe Inovacionit protokolluar me nr.973/1 prot, datë 29.12.2025 “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2025-2026” (**55 bursa për nxënësit e klasave të X-ta**) nga të cilat 43.5 kuota janë zënë dhe 11.5 janë ende të lira.

➤ Kërkesën me nr.67 prot, datë 29.01.2026, për “Shtyrjen e afatit të miratimit të bursave për arsimin e mesëm profesional” dhe konfirmimit të ardhur nga Ministria e Ekonomisë Kultures Dhe Inovacionit.

Komisioni i bursave shqyrtoi kërkesat dhe paraqet pranë Këshillit Bashkiak miratimin e bursës së plotë për nxënësit si vijojnë sipas kriterëve përkatëse:

1-Egli Ilirjan Bixho shkolla e mesme profesionale “Stiljano Bandilli”, në klasën e XI-të, aplikant për bursë sipas kriterit ekonomik pika 2.1.a, aplikant për herë të parë.

2-Blerina Yzeir Bakiu shkolla e mesme profesionale “Stiljano Bandilli”, në klasën e XI-të, aplikant për bursë sipas kriterit jo ekonomik pika 2.3. gj “Nxënëset, të cilat regjistrohen për herë të parë në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja “f”, e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës”, ish përfituese për vitin e shkuar.

3-Seldi Eduart Ismaili shkolla e mesme profesionale “Stiljano Bandilli”, në klasën e XI-të, aplikant për bursë sipas kriterit jo ekonomik pika 2.3 g “Nxënësit me një prind, kur njëri nga prindërit nuk jeton”, ish përfituese për vitin e shkuar.

Në perfundim të procesit u vendos që të propozohen për miratim të bursës për 3 (tre) nxënës, nga të cilët 2 (dy) nxënës përfitues të bursës së plotë dhe 1(një) nxënës gjysëm burse 50%, aplikantë nga shkollat e mesme profesionale.

**Drejtore
Klodiana Hoxha**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA ZNJ. ELONA BURGJIA PËR TË MITURIN
O.BURGJIA.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____._____.2026, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë,

Familja Burgjia, përbëhet nga katër anëtarë dhe jetojnë në lagjen “30 Vjetori”, Berat, në apartamentin të prindërve , banesë e përshtatshme për të jetuar. Strukturat e Shërbimit Social, administratori shoqëror pasi administruan kërkesën e znj. Elona Burgjia nëna e fëmijës, kryhen vizitën në familje dhe vlerësuan nevojat social-ekonomike.



Familja prej vitesh trajtohet me shërbime mbështetëse nga Shërbimi Social, si familje në vështirësi ekonomike dhe në përbërje fëmijë me aftësi ndryshe si pagesën e ndihmës ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe pagesën e ndihmës personal.

Djali i familjes, i diagnostikuar prej vitesh me spektrin autizëm, kohët e fundit kërkon trajtim të specializuar dhe terapi të vazhdueshme pasi nuk mund të ndjekë arsimin gjithëpërfshirës.

Familja është duke u përballur me crregullimet e sjelljes së fëmijës të cilat janë bërë shpesh herë shqetësimin për banorët e pallatit ku jetojnë dhe komunitetin. Fëmija nuk mund të menaxhohet nga prindërit kur e shoqërojnë jashtë banesës apo për të ndjekur terapi pranë Qendrës “Lira”.

Në këtë situatë, ku familja e ka shumë të vështirë të shoqëroj fëmijën për terapi, mungesën e transportit nga Qendra “Lira”, nevojës së tij për rehabilitim dhe riintegrim kërkojnë rimbursimin e shpenzimeve të transportit me mjet taxi.

Të ndodhur në këto kushte dhe vështirësi, duke u bazuar dhe në kërkesën e bërë nga znj.Elona Burgjia, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat ekonomike dhe nevojën për terapi të specializuar për fëmijën, nga strukturat e shërbimit social, kushtet ku jeton familja, propozojmë që znj.Elona Burgjia të mbështetet në masën 40.000 (dyzet mijë) lekë .

Bashkëngjitur gjeni:

1. Certifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
2. Vendimin e komisionit bio-psiko-social.
3. Vërtetim nga Qendra “Lira” për frekuentimin e saj nga fëmija.
4. Vërtetim nga drejtoria e Shërbimit Social.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN FABIOLA
SHENEPREMTE.**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **drejtori i Shërbimit Social** me nr. 79 prot, datë 05.02.2026, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2029”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

E ndjera znj.Fabiola Shenepremte, person i identifikuar në situatë rruge, pa banesë të qëndrueshme. Ajo njihej si e braktisur nga familjarët, të afërm dhe jetonte kryesisht me të vëllain e saj në rrugë, hapësira të hapura duke u përballur me kushte të vështira jetese dhe mungesë të plotësimit të nevojave bazike si higjena, kujdesi shëndetësor, strehimi. Nga vlerësimet dhe mbështetja e dhënë nga shërbimet shoqërore dhe pagesa e paafëtisë, e ndjera u strehua së bashku me të vëllain në një ambient të përshtatur nga bashkia Berat.



Prej disa muajve vuante nga probleme shëndetësore kardiake dhe disa herë është hospitalizuar në Spitalin Rajonal Berat për ndjekjen e terapive.

Nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situata e vështirë e jetesës që e ndjera ka pasur dhe pamundësia, pavarësia që asaj i mungonte për tu kujdesur për veten. Prej dy vitesh kemi dërguar kërkesa të herë pas hershme në institucione për vendosjen në një shtëpi të mbrojtur por kanë rezultuar negative.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit si person pa të afërm e cila nuk zotëron asnjë pasuri, kërkesës së paraqitur nga **drejtori i Shërbimit Social**, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare.
- 2.Certifikata e vdekjes.
- 3.Kërkesën për mbështetje nga drejtori i Shërbimit Social dhe vërtetimi nga përgjegjësia e Shërbimit Social.
4. Faturë tatimore nga subjekti funeral.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL
Piro Xheblati



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. HEKURAN TROKA**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____._____.2026, bazuar në kërkesën e z. Hekuran Troka me nr. 6406 prot, datë 05.11.2026, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë,

Familja Troka, përbëhet nga katër anëtarë dhe jetojnë në lagjen “Clirim”, Berat, në një apartament të të afërmeve, banesë e përshtatëshme për të jetuar. Strukturat e Shërbimit Social, administratori shoqëror i Rajonit 1 pasi administruan kërkesën e z.Hekuran Troka prindi i dy fëmijëve të mitur fëmijës, kryhen vizitën në familje dhe vlerësuan nevojat social-ekonomike.



Familja prej vitesh trajtohet me shërbime mbështetëse nga Shërbimi Social, si familje në vështirësi ekonomike dhe në përbërje të dy prindërit me aftësi ndryshe, të cilët kanë dëmtim në të dëgjuar dhe ju nevojiten mjete ndihmëse. Duke qënë se dëmtimi i aftësive funksionale për të dy prindërit është i moderuar, kanë vështirësi në integrimin në punë.

Fëmijët ndjekin arsimin por mungesat financiare ndikojnë në vazhdimësinë dhe cilësinë e arsimit. Për këtë shkak për ta është shumë e vështirë të sigurojnë nevojat bazike për të dy fëmijët dhe të përballojnë jetesën, pasi të ardhur të vetme kanë mbështetjen financiare mujore për personat me aftësi të kufizuar. Bazuar në informacionin e mbledhur dhe verifikimet e dokumentacionit përkatës, familja ndodhet në kushte të vështira social ekonomike, pas analizës se të ardhurat janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë jetike, duke e vendosur familjen në situatë vështirësie ekonomike.

Të ndodhur në këto kushte dhe vështirësi, duke u bazuar dhe në kerkesën e bërë nga z.Hekuran Troka, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat ekonomike nga strukturat e shërbimit social, kushtet ku jeton familja, propozojmë që z.Hekuran Troka të mbështetet në masën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë .

Bashkëngjitur gjeni:

1. Certifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
2. Vendimet e komisionit bio-psiko-social për të dy prindërit.
3. Vërtetim nga drejtoria e Shërbimit Social.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. SAJMIR MEÇA PËR TË MITURIN
S.MEÇA.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.____.2026, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë,

Familja Meço, përbëhet nga katër anëtarë dhe jetojnë në lagjen “Uznovë” Berat, në një banesë private, banesë e përshtateshme për të jetuar. Strukturat e Shërbimit Social, administratori shoqëror pasi administruan kërkesën e z.Sajmir Meça babai i fëmijës, kryhen vizitën në familje dhe vlerësuan nevojat social-ekonomike.



Familja prej vitesh trajtohet me shërbime mbështetëse nga Shërbimi Social, si familje në vështirësi ekonomike dhe në përbërje fëmijë me aftësi ndryshe si pagesën e ndihmës ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe pagesën e ndihmës personal.

Djali i familjes, i diagnostikuar prej vitesh me encefalopati, paraplegji inferiore i cili paraqet edhe probleme të rënda shëndetësore, herë pas here kërkohet trajtimi i tij spitalor. Ndërkohë, kryefamiljari është i vetmi që siguron të ardhura, të cilat përbëhen nga një pagë minimale, në periudhat kur ai arrin të punojë, si dhe nga pagesa e paaftësisë së djalit. Por për shkak të nevojës së pandërprerë për kujdes ndaj djalit të madh, ai detyrohet shpesh të mungojë ose të lërë punën për periudha të gjata, gjë që sjell rënie të ndjeshme të të ardhurave familjare. Kjo situatë e vendos familjen në kushte të vështira ekonomike dhe e bën të pamundur përballimin e nevojave bazë të jetesës

Familja aktualisht është duke u përballur me vështirësi social-ekonomike por edhe të zhvillimit për djalin i cili kërkon kujdes primar dhe gjatë gjithë kohës duhet dikush të kujdeset. Fëmija nuk mund të kryej asnjë nevojë dhe të plotsojë nevojat bazike, kërkohet patjetër një nga prindërit për tu kujdesur apo për të ndjekur terapi pranë Qendrës “Lira”.

Në përfundim të verifikimit, u konstatua se familja Meca ndodhet në një gjendje të vështirë social-ekonomike, e cila është përkeqësuar ndjeshëm kohët e fundit si pasojë e problemeve shëndetësore të nënës, kujdesit ndaj djalit me aftësi të kufizuara dhe mungesës së të ardhurave të qëndrueshme. Familja ka nevojë për mbështetje të menjëhershme dhe të vazhdueshme nga strukturat përkatëse të bashkisë për të përballuar situatën aktuale ***propozojmë që z.Sajmir Meço të mbështetet në masën 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë .***

Bashkëngjitur gjeni:

1. Çertifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
2. Vërtetim nga KMCAP Tiranë.
3. Relacion social ekonomik të familjes.
4. Vërtetim page për z.Sajmir Meço.
5. Vërtetim nga drejtoria e Shërbimit Social.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN LLAZAR DEVOLE.**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **drejtori i Shërbimit Social** me nr. 80 prot, datë 05.02.2026, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2029”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

I ndjeri Llazar Devole, person i identifikuar në situatë rruge, pa banesë të qëndrueshme, njëhej si i braktisur nga familjarët, të afërm dhe jetonte kryesisht në rrugë, hapësira të hapura duke u përballur me kushte të vështira jetese dhe mungesë të plotësimit të nevojave bazike si higjena, kujdesi shëndetësor, strehimi. Prej viti 2021 drejtoria e Shërbimit Social ka dërguar kërkesa të vazhdueshme për pranimin e z.Devole në shërbim rezidencial, institucion për përkujdesjen e moshës së tretë dhe shoqata në fushën e përkujdesjes dhe integritit social për persona që jetojnë në kushte të papërshtatëshme.



Përherë kërkesat janë refuzuar dhe i ndjeri ka vazhduar të qëndrojë në banesën e tij në katin e parë në lagjen “30 Vjetori” e cila ishte plotësisht e pabanueshme dhe e papërshtatëshme për të jetuar.

Nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situata e vështirë e jetesës që i ndjeri ka pasur dhe pamundësia, pavarësia që atij i mungonte për tu kujdesur për veten

Me Vendimin nr.89, datë 04.12.2025, të KB i ndjeri është sistemuar si rast emergjent rezident pranë Qendrës “Lira” Berat me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimit Social.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit si person pa të afërm, kërkesës së paraqitur nga **drejtori i Shërbimit Social**, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare.
- 2.Certifikata e vdekjes.
- 3.Kërkesën për mbështetje nga drejtori i Shërbimit Social dhe vërtetimi nga përgjegjësia e Shërbimit Social.
4. Faturë tatimore nga subjekti funeral.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati